



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0245**

**OSHP: 2026/ 0249**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Batisha Ibrahimimi -Paneliste Individuale , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik “Te Fatosi” SH.P.K. dhe ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatoreve Ekonomik GOE “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dekorimet verore, dimerore dhe shenimi I datave me rendesi (loto1) - Ritender”, me numër të prokurimit: 616-25-9661-2-1-1te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Prishtines, me datën 22.05.2026, mori këtë:

## **Vendim**

**I** Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik “Te Fatosi” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 17.04.2026 me numër protokolli 0245/26, si dhe Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit te Operatoreve Ekonomik “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. e parashtruar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me 17.04.2026 me numër protokolli 0249/26 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dekorimet verore, dimerore dhe shenimi I datave me rendesi (loto1) - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

**II.** Mbetet ne fuqi vendimi B58 ‘ Njoftim mbi vendimin e AK-se ‘ , per kete aktivitet te prokurimit sikurse në dispozitivin I të këtij vendimi.

**III.** Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës së operatoreve ekonomik si dhe obligohen operatorët ekonomik ankues “Te Fatosi” SH.P.K. dhe “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 27.10.2025, Komuna e Prishtinesnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimerore dhe shenimi I datave me rendesi (loto1) - Ritender” me numër të prokurimit:616-25-9661-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës sherbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 150,000.00 €.

AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar ne tërësi kete aktivitet te prokurimit ne mungese te mjeteve buxhetore per vitin 2026.

Me 30.03.2026, OE “Te Fatosi” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 30.03.2026 po ashtu edhe GOE “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 03.04.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 17/04/2026, OE “Te Fatosi” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0245/26. Ndërsa me datë 17/04/2026 po ashtu edhe GOE “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0249/26.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0245/26 dhe ankesa nr. 0249/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Te Fatosi” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:**

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP 001/2022 pasi që gjatë procesit të ri vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase,

efektive dhe vetëm për qëllimin e lëndës që ishin paraparë. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit si dhe si pasojë e mos respektimit as të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve që vet AK e kishte aprovuar. Thirrja kinse në mungesë buxheti edhe pse paraprakisht mjetet kanë qenë të zotuara dhe të alokuara për projektin në fjalë, është vetëm si arsytim fiktiv dhe kinse shkas sa për të provuar anulimin e procedurës. Me që kur mjetet janë të zotuara, dhe procedura zgjatë duke kaluar në vitin tjetër fiskal, ligjërisht buxheti duhet të bartet automatikisht në vitin vijues dhe nisur nga kjo del që arsytimi i AK-së për anulim të tenderit është i panevojshëm por është edhe i pa mbështetur nga asnjë dispozitë ligjore e LPP-së. Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë faktin që në sistem ndodhet Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve e nënshkruar nga tërë personat kompetent, konstatohet se AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 duke mos vazhduar me vlerësim të tenderëve në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë. Kjo tregon hapur se gjatë ri vlerësimit të tenderëve, AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së i cili ndër të tjera kërkon nga AK që gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe duke mos favorizuar e as diskriminuar ndonjërin prej tyre. Gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me këtë nen pasi që edhe përkundër asaj që ne si OE jemi të vetmit që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat nga Dosja e Tenderit, kjo e fundit po tenton ta anuloj kundërligjshëm tenderin me arsytimin kinse në mungesë buxheti. Arsyeja e shkeljes së këtij neni është edhe mosveprimi për potencimi të mangësive me rastin e publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së tek tenderi i GOE AGRI BAU SHPK & ANEA GROUP SHPK që ishte konkurrent i papërgjegjshëm në këtë tenderi. Edhe shkaqet që AK i përdorë si arsytime për të anuluar tenderin nuk janë fare si mundësi tek neni 62 i LPP-së e as tek neni 43 i RRPP-001/2022 andaj veprimi i AK-së për anulim të tenderit i bie të jetë diskriminim për tenderin tonë. Mos marrja për bazë e rezultateve të dalura nga procedura e hapur dhe mos respektimi i ligjit mbi buxhetin e parashikuar dhe alokuar që vet AK e ka përcaktuar në DNPDPF, tregojnë se anulimi i tenderit me një arsye jo ligjore që askund në LPP dhe RRPP-001/2022 nuk ndodhet si mundësi është veprim diskriminues ndaj neve që konsiderohet edhe shkelje e plotë e parimeve të prokurimit mbi trajtimin e drejtë të OE. Përpos kësaj veprimi i tillë konsiderohet edhe shkelje e plotë e mënyrës së shpenzimit të parasë publike pasi që gjithashtu bie ndesh edhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Të gjitha këto veprime që i cekëm më sipër tregojnë se me rastin e anulimit të tenderit, AK po bënë shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar saktë kërkesat e dosjes së tenderit por është lëshuar vetëm në çështjen e tentimit të anulimit të tenderit me arsytim kinse mungesë buxheti.

Fillimisht duhet theksuar se pavarësisht arsytimit kinse të mungesës së buxhetit, AK është dashur të bëjë edhe vlerësimin e tenderëve pasi që ashtu e kërkon ligji i prokurimit publik dhe praktikata e mira të prokurimit. AK nuk ka bërë vlerësim të tenderëve dhe kjo mundet të krijoj probleme kur lënda kthehet në ri-vlerësim. Edhe arsytimi i AK-së për mos shpërbllim të tenderit tonë nuk lidhet aspak me realitetin dhe as me kërkesat dhe detyrimet që i jep nenin 59 i LPP-së. Sipas kësaj dhe njoftimit të AK-së shihet se AK nuk ka bërë fare vlerësim të tenderëve por vetëm ka konstatuar që kinse mungon buxheti, duke mos dhënë asnjë arsytim të detajuar për gjendjen

e përgjegjshmërisë së tenderuesve. Arsyetimin e bazuar mbi mungesën e buxhetit nuk mundet ta bëjë AK për deri sa e ka të hartuar dhe nënshkruar vet DNPDPF-në saktë ashtu siç e parasheh ligji. Përpos kësaj AK gjatë vlerësimit nuk ua ka atribuar fare mangësitë në tenderin e tyre Grupit të OE “AGRI BAU SH.P.K. & ANEA GROUP SH.P.K.”. Kjo shihet tek arsyetimi për eliminimin e tenderuesve AK ku ka thënë se gjoja nuk kemi qenë asnjëri tenderues të suksesshëm që në një formë Grupit të OE konkurrent ia ka pranuar tenderin si të përgjegjshëm edhe përkundër shumë mangësive që ai i posedon. Për qëllim të sqarimit të situatës ne duhet të cekim ato mangësi, pavarësisht që AK e ka publikuar njoftimin për anulim të tenderit. Grupi i OE “AGRI BAU SH.P.K. & ANEA GROUP SH.P.K.” ka shumë mangësi në tenderin e tij të cilat realisht edhe AK është dashur të ja potencoj të gjitha.

Mangësia 1: GOE “AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK” në tenderin e tij ka paraqitur një deklaratë lidhur me vizualitetin e figurave dhe specifikimeve teknike ku ka deklarua se ato janë të ngjashme deri në 90% në krahasim me figurat dhe specifikimet teknike të paraqitura në paramasën e AK-së.

Fillimisht shtrohet pyetja se si mundet që GOE të jap deklaratë të tillë për figura që nuk i posedonte në kohën e tenderimit e të cilat realisht për prodhim marrin kohë së paku një muaj që dukshëm tregon se e tejkalon kohën kur parashihet të instaloheshin si të tilla? Bazuar në nenin 9.3 të Informatave për Tenderuesit nga dosja e tenderit ku thuhet që: autoriteti kontraktues, me shpenzimet e tij, mund të kryejë një inspektim të kompanive të operatorëve ekonomikë për qëllime të verifikimit, AK ka kryer vizita tek tenderuesit për tu siguruar që artikujt e tyre të cilët do të instalohen e përbushin 90% të ngjashmërisë me format vizuale të artikujve të paraqitura në paramasë. Në bazë të procesverbalit që e kemi siguruar me rastin e qasjes në dokumentet e tenderit, shihet që GOE “AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK” nuk e kanë përbushur kushtin e tillë pasi që nuk kanë arritur të ua dëshmojnë komisionit që figurat e ofertuara nga ky GOE janë të ngjashme me figurat e kërkuara nga AK së paku deri në masën 90%. Në raport shihet përfaqësuesi i GOE në fjalë ka konstatuar para komisionit se nuk i posedojnë por do të i kenë kinse të gatshme në fazën e implementimit të kontratës. Në bazë të kësaj dhe në bazë të kohës së limituar për prodhimin e tyre si dhe çdo herë mbështetur në volumin e madh që posedojnë figurat e tilla, shihet se ky GOE nuk ishte aspak i gatshëm për realizim të kontratës në fjalë dhe realisht ka rrezikuar hapur edhe dështimin e kontratës. Nisur nga rezultati i verifikimit, nisur nga dispozitat ligjore dhe nisur nga kërkesa e pikës 9.3 që ndodhet tek Informatat për Tenderuesit, AK është dashur të ja potencoj mangësinë e tillë e jo ta konsideroj si tenderues të pasuksesshëm. Pra me vet faktin që ky GOE ka deklaruar në tender se modelet e figurave të tyre e plotësojnë 90% të pamjes vizuale në krahasim specifikimet teknike të figurave të paramasës, ndërsa gjatë vizitës në depot e tyre nuk ka qenë asnjë figurë e gatshme për prezantim, tregon se komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me ligjin kur nuk e ka cilësuar si mangësi mos posedimin dhe mos prezantimin e figurave të ofertuara. Komisioni i vlerësimit tek ne ka kërkuar të i shoh të gjitha mostrat të cilat edhe i ka fotografuar ndërsa tek GOE i shpallur fitues është mjaftuar vetëm me deklarinimin e tyre që kinse gjatë implementimit të kontratës do të i sjellin ato siç janë kërkuar. Ky veprim i komisionit është jo ligjor pasi po shihet që është aplikuar standard i dyfishtë në vlerësimin dhe verifikimin e dukjeve të figurave që ishin kërkuar nga vet AK. Me që deklarata për specifikimet teknike është pjesë e përshtatshmërisë profesionale dhe me që sipas të drejtës për vizitë është konstatuar se deklarata e tillë nuk është përbushur, GOE në fjalë detyrimisht është dashur të eliminohet nga konkurrenca si tenderues i papërgjegjshëm e jo të lihet si i pasuksesshëm. Nisur nga kjo, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që pretendimin për mungesën e dëshmive të cekura dhe veçanërisht mungesën e prezantimit të figurave për konstatim të ngjashmërisë siç ka deklaruar tenderuesi, do ta vlerësoj drejt dhe të bazuar për çka besojmë se

GOE në fjalë edhe do të konsiderohet i papërgjegjshëm në këtë pikë.

Mangësia 2: GOE “AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK” posedonte mangësi edhe tek pajisjet e ofruara pasi që nuk e plotësonte kërkesën e AK-së për posedim apo marrje me qira me marrëveshje të rregullta të së paku dy shportave ngritëse për montim te ndriçimit dhe dekorimeve. Këtë e themi sepse në Marrëveshjet për marrje me qira të shportave nga OE BINI CLEANERS SHPK dhe ETM GROUP SHPK nuk e kanë të përfshirë në marrëveshje emrin dhe numrin e prokurimit për çka janë paraqitur, ndërsa shporta e OE BINI CLEANERS SHPK është edhe me afat të skaduar të regjistrimit. Me që kamioni i OE AGRIBAU SHPK është vinç e jo shportë që si i tillë nuk pranohet, vijmë deri te konstatimi se vetëm kamioni me shportë i OE ANEA SHPK e plotëson kushtin për tu konsideruar i pranueshëm. Nisur nga krejt kjo, konstatohet se GOE në fjalë nuk e ka plotësuar kriterin për pajisjet andaj ky GOE është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm nga ana e komisionit të vlerësimit. Ja si duket librezja e regjistrimit pa afat e shportës së OE BLINI CLEANERS SHPK dhe marrëveshjet për shporta pa emër dhe pa numër të prokurimit dëshmitë e paraqitura nuk janë të pranueshme si të tilla, konsiderojmë se GOE në fjalë është dashur të konsiderohet si i papërgjegjshëm.

Mangësia 3: GOE “AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK” nuk e posedon certifikatën ISO sipas kërkesës së AK-së sepse kësaj certifikate nuk i përputhen të dhënat në data brenda sajë.

GOE “AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK” ka paraqitur një certifikatë që sipas të dhënave duket se ka skaduar një ditë pas hapjes publike. Edhe me rastin e verifikimit në faqen e lëshuesit të sajë tregohet njëjtë se kjo certifikatë tashmë është e skaduar dhe nuk është vazhduar me kohë. Ja si duket certifikata e tillë dhe të dhënat mbi datën e skadimit të sajë.

Ngjashëm duket edhe në faqen e lëshuesit të certifikatës nga ku në bazë të të dhënave vërtetohet se akoma nuk është bërë second surveillance e paraparë për datën 14.10.2025 dhe kjo tregon se certifikata nuk është vazhduar akoma. Se certifikata e tillë nuk është vazhduar e tregon edhe fakti që ky GOE më pas gjatë ankimit ka paraqitur një ISO certifikatë tjetër të lëshuar nga një trupë certifikuese e ndryshme me të parën ku data e lëshimit/certifikimit është 18.11.2025. Ja si duket kjo nga faqja e lëshuesit të certifikatës së skaduar sot me datën 17.04.2026. vet fakti që akoma i figuron aktive dhe ky GOE tashmë ka certifikatë tjetër të lëshuar nga një trupë e ndryshme certifikuese, tregon se diçka nuk ka qenë në rregull me certifikatën por edhe me trupën e parë certifikues.

Sipas kësaj që shihet në informatat e tilla del që certifikata e tillë me datë 13.11.2025 është e skaduar dhe e njëjta nuk mundet as të sqarohet me që nuk është bërë second surveillance e paraparë për datën 14.10.2025. Kjo konstatohet sidomos kur e shohim certifikatën që OE AGRIBAU SHPK e kishte paraqitur vitin e kaluar në tenderin e njëjtë ku tregohej se data e skadences ka qenë 13.11.2024 ndërsa data e parashikuar e first surveillance ishte 14.10.2024 (një muaj para skadimit). Me që në certifikatën e re nuk shkruan data e first surveillance por krahasuar me certifikatën e vjetër shihet se ajo ishte vazhduar vetëm për një vit dhe atë deri me datën 13.11.2025. Tash me që nuk kemi të dhëna nga sistemi se second surveillance është kryer së paku deri më 14.10.2025, tregon qartë se certifikata pas datës 13.11.2025 është e skadur. Edhe nëse vazhdohet, i bie të ketë ndërprerje të vlefshmërisë së sajë andaj në rastet e tilla tenderuesi duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm. Komisioni i vlerësimit është dashur të kërkoj certifikatën e vazhduar por që nuk e ka bërë dhe me që akoma në sistem të verifikimit figuron certifikata me afat të skaduar, konsiderojmë se OE nuk e ka plotësuar kushtin e kërkuar nga AK për sa i përket ISO certifikatës. Edhe pse gjatë kontestimit në OSHP ky GOE ka paraqitur një

certifikatë të re nga një kompani tjetër, shihet se certifikata e tillë fillon nga data 18.11.2025 dhe si e tillë nuk mundet të pranohet. Prap ky GOE realisht konsiderohet i papërgjegjshëm për faktin se ka ndërprerje të certifikimit për 5 ditë andaj nuk mundet në asnjë formë të pranohet certifikata e tillë çka e bënë tenderuesin në fjalë të papërgjegjshëm. Certifikata kishte mundur të pranohej nëse do fillonte nga data 13.11.2025 por me që ajo fillon të jetë validhe prej datës 18.11.2025, certifikimi i kompanisë posedon shkëputje e që GOE-në e bënë të papërgjegjshëm. Sa për dijeni po ju bashkangjesim certifikatën e tillë dhe të njëjtën po ua paraqesim edhe vizualisht ku edhe sipas nenit 72 të LPP-së, pranimi i sajë konsiderohet plotësim material i dosjes së tenderit me dëshmi që posedojnë datën e lëshimit pas hapjes publike.

Sipas krejt kësaj që u tha më lartë, po shihet qartë që GOE AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK është tenderues i papërgjegjshëm sepse posedon mangësi të theksuara në tenderin e tyre dhe nisur nga kjo del që komisioni i vlerësimit ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së si dhe nuk ka respektuar fare kërkesat e dosjes së tenderit me rastin e cilësimit të këtij GOE si tenderues i pasuksesshëm. Pra mos eliminimi i tijë nga konkurrenca për kërkesat e paplotësuara që ishin të përcaktuara tek dosja e tenderit dhe mos shpallja si fitues i tenderit tonë, e shtyjnë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së si dhe drejt shkeljes edhe të dispozitave ligjore që flasin për administrimin e mirëfilltë të procedurave të prokurimit dhe të administrimit me buxhetin e vet AK-së.

Pretendimi 4: AK ka shkelur Nenin 62 të LPP-së dhe Nenin 43 të RRPP-së pasi ka ndërprerë/anuluar një proces të prokurimit pa u plotësuar asnjëri nga kushtet e lejuara sipas neneve të cekura më lartë. Sipas nenit 62 të LPP-së AK mundet ta anuloj tenderin pas hapjes publike.

Bazuar në njoftimin për anulim të AK-së shihet qartë se asnjëra nga kushte e mësipërme të nenit 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 nuk janë plotësuar. Sipas kësaj, me plot përgjegjësi mund të deklarojmë se AK ka shkelur nenet e cekura në këtë pretendim sepse ka anuluar tenderin në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP 001/2022. Realisht AK këtu po paraqet informata jo reale duke shkelur plotësisht ligjin për financat publike dhe për buxhetin por edhe ligjin e prokurimit publik pasi që në rastet e tilla vet AK duhet ta bartë buxhetin në vitin vijues. Nisur nga krejt kjo që u sqarua më sipër, po shihet se AK ka anuluar tenderin pa u plotësuar asnjëri nga kushtet e neneve të cilat ia mundësojnë AK-së ndërprerjen e procedurave të prokurimit pas hapjes publike, andaj me të drejtë konsiderojmë se me veprimin e anulimit të procedurës së prokurimit, AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP 001/2022.

**Pretendimet e grupit te operatoreve ekonomik ankues “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:**

#### **Pretendimi 1.**

Ju si Autoritet Kontraktues keni Anuluar Aktivitetin e Prokurimit ne kundërshtim me Ligjin

e Prokurimit Publik dhe ne kundërshtim me Rregulloren Nr.002/2024 Përplotësimin Dhe Ndryshimin E Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar) Marrja e këtij vendimi përbën shkelje flagrante te Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe është në kundërshtim me Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga Autoriteti Kontraktues. Organi Shqyrtues i Prokurimit, përmes vendimit nr. 2025/1277, ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe ka urdhëruar kthimin e

lëndës në rivlerësim. Në këtë vendim është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe është obliguar që gjatë rivlerësimit të respektojë plotësisht dispozitat ligjore.

Në këtë kuptim, AK ka qenë e detyruar të zhvillojë një rivlerësim të drejtë, objektiv dhe në përputhje me gjetjet e panelit të OSHP-së, e jo të ndërmarrë veprime që e bëjnë të pavlefshëm vetë procesin e rivlerësimit.

Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i marrë pas kthimit në rivlerësim, paraqet në thelb një shmangie të qëllimshme të zbatimit të vendimit të OSHP-së.

Në vend që të adresohen shkeljet e konstatuara dhe të bëhet rivlerësimi në përputhje me ligjin, AK ka zgjedhur të anulojë procedurën, duke e bërë të pavlefshëm efektin juridik të vendimit të OSHP-se.

Ky veprim bie ndesh me parimet themelore të LPP-së, pikërisht me Neni-ne 62-Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, si dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, trajtimin e barabartë, dhe detyrimin për zbatim të vendimeve të organeve kompetente.

Ky veprim bie ndesh edhe me Neni-in 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik versioni i konsoliduar, pikërisht Neni 40.2.1 ku thuhet; Neni-40.2.1 Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korrigjuar parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korrigjuar parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve. SH.P.A6

Më datë 22.10.2025 Autoriteti Kontraktues ka Ri-tenderuar këtë aktivitet të prokurimit për "Dekorimin e qytetit përmes procedurës së hapur me nr. prokurimi 616-25-9661-2-1-1 me titull;DEKORIMET VERORE, DIMERORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDESKLOTO D-Ri tender. Dhe tek FTD ka potencuar se Kjo Kontrate Publike ka kohëzgjatje prej 24 muaj;

Prandaj arsyetimi i AK-se për mungesë të buxhetit është tendence për ti ikur respektimit të vendimit të OSHP-se dhe gjetjeve nga Paneli Shqyrtues.

## **Pretendimi; 2**

Me datën 03.04.2026 AK ka marrur vendimin për Refuzim të kërkesës tone duke e konsideruar si të Pa Bazuar mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi pretendimet tona por vetëm ka vlerësuar se kërkesa për rishqyrtim është e Pabazuar. Kjo mënyrë e refuzimit të kërkesës tone për Rishqyrtim pa e arsyetuar vendimin për Refuzim për secilin pretendim tone është në kundërshtim të plote me Neni-in 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Ky veprim i AK-së përbën refuzim formal, jo rishqyrtim real, në kundërshtim me standardet minimale të arsyetimit të një vendimi administrativ.

Autoriteti Kontraktues: nuk ka analizuar asnjë nga argumentet tona juridike, nuk ka dhënë sqarim për asnjë nga pretendimet, nuk ka dhënë referenca ligjore konkrete, nuk ka bërë vlerësim të provave të dorëzuara.

Si i tille, vendimi i refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim është i pabazuar, arbitrar dhe i kundërligjshëm, në shkelje direkte të nenit 7 të LPP-së (trajtimi i barabarte), nenit 10 të LPP-së (transparenca), nenit 108/A 18 LPP-se (detyrimi për shqyrtim real). Ky vendim përbën shkelje flagrante të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe është në kundërshtim me përbën shkelje flagrante të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe është në kundërshtim me Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga Autoriteti Kontraktues.

Ne besojmë thëllësisht se mos Arsytimi i vendimit dhe mos sqarimi në asnjërën pikë të Pretendimeve tona, ka ardhur si shkak që: Oferta jonë ishte plotësisht e përgjegjshme dhe e vërtetuar edhe me vendimin e OSHP-se dhe AK nuk ka patur asnjë argument për ta arsyetuar Vendimin e tyre.

Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe dispozitave ligjore të aplikueshme,

konstatojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit është në kundërshtim të plotë me nenet e lartcekura të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe me Rregulloren nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, duke cenuar rëndë parimet themelore të ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Duke u mbështetur të neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 17.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0245/2026 ndërsa me datën 20.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0249/2026, ndërsa me datë 02.05.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0245/26&0249/2026.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

#### **Lidhur me pretendimet e OE “Te Fatosi” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0245 kanë vlerësuar si në vijim:**

Pretendimet ankimore lidhen me kundërshtimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, procedurë e cila më herët ka qenë objekt shqyrtimi në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në mënyrë të përgjithshme.

Në këtë rast, Eksperti shqyrtues e sheh të nevojshme të sqaroj kronologjinë e këtij aktiviteti të aktivitetit të prokurimit Kontraktues.

Komuna e Prishtinës pas dështimit të procedurës për lidhjen e kontratës për herën e parë sektori i prokurimit ka ri-publikuar Njoftimin për Kontratë më datë 22.10.2025 për aktivitetin me titull: Më datë 12.11.2025 është bërë hapja e ofertave, ku kanë ofertuar dy operatorë ekonomikë (të dy ankues në këtë aktivitet).

1. Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) “AGRI BAU” SH.P.K. & “ANEA GROUP” SH.P.K., me adresë në Zonën Industriale te Amortizatorët -1, 10000 Prishtinë Oferta financiare: 93,340.00€

2. OE “Te Fatosi” SH.P.K. – Oferta financiare: 94,782.00 €

Heren e parë Autoriteti kontraktues në këtë procedurë prokurimi-Ritender ka shpërblyer (GOE) “AGRI BAU” SH.P.K. & “ANEA GROUP” SH.P.K., AK-Komuna e Prishtinës ka kthyer lenden në Ri-vlerësim pas ankesës se OE “Te Fatosi” SH.P.K duke e shpërblyer me kontratë për here të dytë OE “Te Fatosi” SH.P.K

Sektori i prokurimit ne kuader te AK-së ka bërë dy herë propozim për dhënie të kontratës, mirëpo procedura nuk ka përfunduar me sukses për shkak të ankesave nga OE, dhe lënda është dërguar në OSHP më datë 26.12.2025, ku OSHP me datën 20.02.2026 ka nxjerre vendim OSHP: 2025/1277 me te cilin vendim lënda është rikthyer ne rivlerësim.

Pas kësaj Eksperti shqyrtues duke iu referuar raportit të ri-vlerësimit të nënshkruar nga personat përgjegjës ka kuptuar se përmes shkresave zyrtare të datës 11.03.2026, Drejtoria për Kulturë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në kuadër të Komunës së Prishtinës ka njoftuar Drejtorinë e Prokurimit se për këtë aktivitet nuk ka mjete financiare të disponueshme për vitin 2026, pasi mjetet e parapara për këtë projekt janë shpenzuar.

Duke u bazuar në të gjitha këto, Komisioni i Rivlerësimit, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të gjitha fakteve dhe dokumenteve relevante, i ka rekomanduar ZPP-së anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për shkak të mungesës së mjeteve financiare për vitin 2026 të cilat nuk janë paraparë ne buxhetin e AK-së 2026. Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht nenin 62 (Anulimi i aktivitetit të prokurimit) dhe duke u bazuar në pretendimet ankimore te OE ankues lidhur me anulimin e aktiviteti te prokurimit, sqaron se bazuar ne Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konkretisht në nenin 8 “Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve”, paragrafët 8.3, 8.4 dhe 8.5, vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka për obligim që, para inicimit dhe gjatë gjithë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, të sigurojë dhe të dëshmojë se ekzistojnë mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e kontratës. Këto dispozita përcaktojnë qartë se asnjë aktivitet i prokurimit nuk duhet të vazhdohet pa u konfirmuar disponueshmëria reale e fondeve, ndërsa në fazën para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (formulari B58), kërkohet rikonfirmimi i Deklaratës për Nevojat dhe Disponueshmërinë e Fondeve (DNPDF), për të garantuar se gjendja financiare nuk ka ndryshuar (shih neni).

8.3 DNPDF do të jetë pjesë e rexhistrit të dokumentacioneve të aktivitetit të prokurimit.

8.4 Gjatë përgatitjes së DNPDF, AK duhet të plotësoj në mënyrë të saktë dhe qartë të gjitha pjesët e deklaratës.

8.5 Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar.

Bazuar ne DNPDF Aktiviteti i prokurimit është planifikuar fillimisht si projekt dy vjeçar procedure e hapur -Kontratë kornizë për periudhën 2024–2025, me mjete të alokuara për realizimin e tij. Megjithatë, për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë dhe procedurave të shqyrtimit, ky aktivitet nuk ka mundur të përfundojë brenda afateve të planifikuara dhe ka kaluar në vitin 2026.

Në këtë kontekst, çdo vazhdim i procedurës në mungesë të mjeteve të konfirmuara financiare bie ndesh me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe paraqet shkelje të parimeve të menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike, duke e bërë të paqëndrueshëm ligjërisht vazhdimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues është i bazuar në faktin se projekti ka qenë i planifikuar si projekt dy vjeçar -Kontratë kornizë për vitet 2024 dhe 2025, ndërsa për shkak të zgjatjes së procedurave (përfshirë ankesat), realizimi i tij ka kaluar në vitin 2026, për të cilin nuk janë siguruar mjete financiare. Anulimi i procedurës për shkak të mungesës së mjeteve financiare është në përputhje me parimet e prokurimit publik; megjithatë, kjo situatë nxjerr në pah mangësi nga AK në planifikimin buxhetor dhe në garantimin e qëndrueshmërisë financiare të projektit që në fazën fillestare të procedurës

Meqenëse Rregullorja për Prokurim Publik, neni 8, par. 8.5 obligon personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF që para publikimit të formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar, ekspertja shqyrtuese konsideron se vazhdimi i këtij aktivitet të prokurimit në mungesë të fondeve mund të qoj në një shkelje të ligjit ashtu siç parashihet në nenin 62.1 pik 1.1 të LPP-së. Andaj, konsideroj se AK ka zbatuar drejt dispozitat ligjore në lidhje me anulimin e kësaj procedure për shkak se neni 62.1 pika 1.1 e ligjit për Prokurim Publik, parasheh:

*1.1.një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet për mes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

Duke u bazuar në ankesën e Operatorit Ekonomik ankues, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, duke marrë parasysh shpenzime e ofertimit të cilat i bartë operatori ekonomik (përfshirë sigurimin e tenderit dhe tarifën e ankesës), ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Kjo për arsye se anulimi i procedurës së prokurimit nuk ka ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të Operatorit Ekonomik ankues, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare nga ana e Autoritetit Kontraktues.

**Lidhur me pretendimet e GOE “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0249 kanë vlerësuar si në vijim:**

Pretendimet ankimore lidhen me kundërshtimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, procedurë e cila më herët ka qenë objekt shqyrtimi në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Eksperti shqyrtues ka dhene pergjigje në menyre të përgjithshme.Në këtë rast, Eksperti shqyrtues e sheh të nevojshme te sqaroj kronologjinë e këtij aktiviteti të aktivitetit të prokurimit Kontraktues.

Komuna e Prishtinës pas dështimit të procedurës për lidhjen e kontratës për herën e parë sektori i prokurimit ka ri-publikuar Njoftimin për Kontratë më datë 22.10.2025 për aktivitetin me

titull:Më datë 12.11.2025 është bërë hapja e ofertave, ku kanë ofertuar dy operatorë ekonomikë( të dy ankues në këtë aktivitet).

1. Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) “AGRI BAU” SH.P.K. & “ANEA GROUP” SH.P.K., me adresë në Zonën Industriale te Amortizatorët -1, 10000 Prishtinë Oferta financiare: 93,340.00€

2. OE “Te Fatosi” SH.P.K. – Oferta financiare: 94,782.00 €

Heren e parë Autoriteti kontraktues në këtë procedurë prokurimi-Ritender ka shpërblyer (GOE) “AGRI BAU” SH.P.K. & “ANEA GROUP” SH.P.K.,AK-Komuna e Prishtinës ka kthyer lenden në Ri-vlerësim pas ankesës se OE “Te Fatosi” SH.P.K duke e shpërblyer me kontratë për here të dytë OE “Te Fatosi” SH.P.K

Sektori i prokurimit ne kuader te AK-së ka bërë dy herë propozim për dhënie të kontratës, mirëpo procedura nuk ka përfunduar me sukses për shkak të ankesave nga OE, dhe lënda është dërguar në OSHP më datë 26.12.2025, ku OSHP me datën 20.02.2026 ka nxjerre vendim OSHP: 2025/1277 me te cilin vendim lënda është rikthyer ne rivlerësim.

Pas kësaj Eksperti shqyrtues duke iu referuar raportit të ri-vlerësimit të nënshkruar nga personat përgjegjës ka kuptuar se përmes shkresave zyrtare të datës 11.03.2026, Drejtoria për Kulturë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në kuadër të Komunës së Prishtinës ka njoftuar Drejtorinë e Prokurimit se për këtë aktivitet nuk ka mjete financiare të disponueshme për vitin 2026, pasi mjetet e parapara për këtë projekt janë shpenzuar.

Duke u bazuar në të gjitha këto, Komisioni i Rivlerësimit, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të gjitha fakteve dhe dokumenteve relevante, i ka rekomanduar ZPP-së anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për shkak të mungesës së mjeteve financiare për vitin 2026 të cilat nuk janë paraparë ne buxhetin e AK-së 2026. Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht nenin 62 (Anulimi i aktivitetit të prokurimit) dhe duke u bazuar në pretendimet ankimore te OE ankues lidhur me anulimin e aktiviteti te prokurimit, sqaron se bazuar ne Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konkretisht në nenin 8 “Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve”, paragrafët 8.3, 8.4 dhe 8.5, vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka për obligim që, para inicimit dhe gjatë gjithë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, të sigurojë dhe të dëshmojë se ekzistojnë mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e kontratës. Këto dispozita përcaktojnë qartë se asnjë aktivitet i prokurimit nuk duhet të vazhdohet pa u konfirmuar disponueshmëria reale e fondeve, ndërsa në fazën para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (formulari B58), kërkohet rikonfirmimi i Deklaratës për Nevojat dhe Disponueshmërinë e Fondeve (DNPDP), për të garantuar se gjendja financiare nuk ka ndryshuar (shih neni).

8.3 DNPDP do të jetë pjesë e rexhistrit të dokumentacioneve të aktivitetit të prokurimit.

8.4 Gjatë përgatitjes së DNPDP, AK duhet të plotësoj në mënyrë të saktë dhe qartë të gjitha pjesët e deklaratës.

8.5 Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të

rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar.

Bazuar ne DNPDP Aktiviteti i prokurimit është planifikuar fillimisht si projekt dy vjeçar procedure e hapur -Kontratë kornizë për periudhën 2024–2025, me mjete të alokuara për realizimin e tij. Megjithatë, për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë dhe procedurave të shqyrtimit, ky aktivitet nuk ka mundur të përfundojë brenda afateve të planifikuara dhe ka kaluar në vitin 2026.

Në këtë kontekst, çdo vazhdim i procedurës në mungesë të mjeteve të konfirmuara financiare bie ndesh me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe paraqet shkelje të parimeve të menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike, duke e bërë të paqëndrueshëm ligjërisht vazhdimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues është i bazuar në faktin se projekti ka qenë i planifikuar si projekt dy vjeçar -Kontratë kornizë për vitet 2024 dhe 2025, ndërsa për shkak të zgjatjes së procedurave (përfshirë ankesat), realizimi i tij ka kaluar në vitin 2026, për të cilin nuk janë siguruar mjete financiare. Anulimi i procedurës për shkak të mungesës së mjeteve financiare është në përputhje me parimet e prokurimit publik; megjithatë, kjo situatë nxjerr në pah mangësi nga AK në planifikimin buxhetor dhe në garantimin e qëndrueshmërisë financiare të projektit që në fazën fillestare të procedurës

Meqenëse Rregullorja për Prokurim Publik, neni 8, par. 8.5 obligon personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP që para publikimit të formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar, ekspertja shqyrtuese konsideron se vazhdimi i këtij aktivitet të prokurimit në mungesë të fondeve mund të qoj në një shkelje të ligjit ashtu siç parashihet në nenin 62.1 pik 1.1 të LPP-së. Andaj, konsideroj se AK-Sektori i prokurimit ka zbatuar drejt dispozitat ligjore në lidhje me anulimin e kësaj procedure pasi që vazhdimi tutje pa mjete financiare buxhetore per nënshkrim te kontrates do te shipe Ak nje obligim ligjor te jasht ligjshem e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet për mes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, keshtu qe AK për shkak se neni 62.1 pika 1.1 e ligjit për Prokurim Publik, parasheh:

1.1.një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet për mes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Duke u bazuar në ankesën e Operatorit Ekonomik ankues, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, duke marrë parasysh shpenzime e ofertimit të cilat i bartë operatori ekonomik (përfshirë sigurimin e tenderit dhe tarifën e ankesës), ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Kjo për arsye se anulimi i procedurës së prokurimit nuk ka ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të Operatorit Ekonomik ankues, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare nga ana e Autoritetit Kontraktues.

*-Seanca shqyrtuese-*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa

parashtrësas e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues: “Te Fatosi” SH.P.K. po ashtu edhe te GOE “Agri Bau” SH.P.K. & “Anea Group” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin në raportet e ekspertizë me nr 0245/26 0249/26 , kjo duke u mbështetur edhe në sqarimet e dorëzuara nga AK ku PSH përmes mjeteve elektronike ( emailit ) me datën 20.05.2026 ka kërkuar nga AK-ja deshmë nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ në raste se nuk ka mjete sikurse është anuluar kjo procedur, dhe pas pranimit të përgjigjjes se pranuar të datës 21.05.2026 , PSH mbështet vendimin e AK-se , mirpo ankesat e OE i cilëson si pjesërisht të bazuara për faktin se pa fajin e tyre kjo procedur është anuluar dhe poashtu

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli Shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe deklaratës zyrtare të Zyrtarit Kryesor Financiar të Autoritetit Kontraktues, konstaton se ky aktivitet i prokurimit nuk mund të implementohet apo të nënshkruhet për shkak të mungesës objektive të mjeteve buxhetore. Përderisa Paneli Shqyrtues ka për detyrë të sigurojë ligjshmërinë dhe transparencën e procesit të prokurimit, ai nuk mund të detyrojë një Autoritet Kontraktues të hyjë në obligime financiare kontraktuale të cilat nuk janë të mbuluara me zotim të fondeve, pasi kjo do të binte në ndesh të

drejtpërdrejtë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues e pranon si të bazuar anulimin e kësaj procedure për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore. Megjithatë, Paneli do ta monitorojë me vëmendje të shtuar ecurinë e mëtutjeshme të këtij aktiviteti, ngase ky vendim nuk i liron palët nga përgjegjësia ligjore nëse vërtetohet se arsyetimi i mungesës së buxhetit është përdorur si mjet për të anashkaluar këtë procedurë. Për këtë arsye, Paneli Shqyrtues rezervon të drejtën e monitorimit dhe rishqyrtimit *ex-officio* (sipas detyrës zyrtare) nëse ky aktivitet rishpallet nën rrethanat e njëjta.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat janë sanksionuar në mënyrë të veçantë në nenin 104 të LPP-së, Paneli ka analizuar shkresat e lëndës në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara më sipër, duke u kushtuar vëmendjen e duhur edhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Paneli bën vlerësimin e pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1 të Ligjit të cituar, sipas të cilit: *“Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...”*. Ky vendim është gjithashtu në harmoni me nenin 1 të LPP-së, qëllimi i të cilit është: *“...të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me mosdiskriminim, me një shkallë të lartë transparence dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”*.

Prandaj, Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së që rregullojnë situata të tilla në aktivitetet e prokurimit. Duke vepruar në pajtim me kompetencat e lartpërmendura, nenin 104 (paragrafët 1 dhe 4), si dhe duke iu referuar nenit 117 të LPP-së dhe provave të prezantuara, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Te Fatosi SH.P.K., AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: